



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës**

V E N D I M

Nr. 88 Datë 02.10.2008

**Për
Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e
Importit të Grurit dhe Prodhimit të Miellit**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.10.2008 shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Importit të Grurit dhe Prodhimit të Miellit, për ekzistencën ose jo të praktikave që sjellin kufizime të konkurrencës në treg.

Baza ligjore:

- Nenet 24, shkronja d, neni 26, si dhe neni 43 pika 1 i Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi Hetimin Paraprak në Tregun e Importit të Grurit dhe Prodhimit të Miellit” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit ka një shkallë të lartë përqendrimit dhe integrimi.

2. Ndërmarrjet kryesore të importit të grurit janë të integruara vertikalisht edhe në industrinë e blojës, çka u ka dhënë mundësinë të ndjekin sjelljet e njëra-tjetrës lidhur me ofertën dhe çmimet. Ndërmarrjet më të mëdha të importit të grurit kanë pjesë të konsiderueshme edhe në tregun e miellit duke imponuar sjelljet e tyre ndaj konkurrentëve me pjesë më të vogël tregu.
3. Për periudha të caktuara kohe, ndërmarrjet ofertuese të miellit kanë pasur ritme të ngjashme të rritjes së çmimeve çka provohet nga faturat dhe librat e shitjes. Rritja paralele e çmimeve, që nënkuptojnë ndryshime të njëjta ose të ngjashme në çmime mes rivalëve, janë element i rëndësishëm i koordinimit të sjelljes.
4. Ka varësi të konsiderueshme të klientëve ndaj ndërmarrjeve furnitore për shkak të pozitës dominuese dhe pafuqisë së klientëve për të kundërvepruar.
5. Çmimi i shitjes së miellit është rritur në ritme më të larta se çmimi i shitjes së grurit.
6. Ka kufizime për hyrje të reja në treg për shkak të përqendrimit dhe integritit relativisht të lartë të tregut, ka një varësi të konsiderueshme të klientëve ndaj ndërmarrjeve furnitore për shkak të detyrimeve debitore dhe një kundërveprim të dobët të tyre (furrave të prodhimit të bukës), çka vështirëson konkurrentët e rinj;
7. Konstatohet një manipulim i çmimeve të shitjes së grurit dhe miellit në dëm të prodhuesve të miellit dhe të bukës.
8. Ka pamjaftueshmëri të prodhimit vendas për të plotësuar kërkesat e klientëve, çka rrit varësinë nga importet e grurit për prodhimin e bukës;

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës duke çmuar dhe vlerësuar faktet dhe provat shkresore të administruara në dosjen e hetimit paraprak, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenin 43 pika 1 të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe nenit 21, pika 4, të Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Importit Grurit ndaj ndërmarrjeve:
 1. Bloja SHA,
 2. Atlas SHA,
 3. Miell Tirana SHA,
 4. Alagro SHPK,
 5. IAM SHPK,

6. Alb-Mines Investment SHPK,
7. Vllaznimi-B SHPK,
8. Italia-Agrifood SHPK,
9. Alcor-Grain,
10. Shabani,

për ekzistencën ose jo të marrëveshjes së ndaluar dhe/ose abuzimit me pozitën dominuese.

II. Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës, për ndërmarrjet si më poshtë:

1. Bloja SHA,
2. Mielli, ShA,
3. Atlas SHA,
4. Italia Agrifood SHPK,
5. Abdurrahmani SHPK,
6. Alb Mines Investment SHPK,
7. Onir SHPK,
8. Euromiell Erina SHPK,
9. Skraqi SHPK.

për ekzistencën ose jo të marrëveshjes së ndaluar dhe/ose abuzimit me pozitën dominuese.

III. Hetimi i Thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01 Janar 2005 deri në 31 Gusht 2008.

V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R